

Të nderuar përfaqësues të mediave,

Të nderuar qytetarë,

Më lejoni të ju falënderoj për praninë tuaj në këtë konferencë të fundit, në përfundim të mandatit 5 vjeçar të Guvernatorit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës. Gjithashtu, më lejoni të ju falënderoj për bashkëpunimin e vazhdueshëm dhe efektiv që kemi kultivuar gjatë pesë viteve të fundit dhe informimin e publikut rreth aktiviteteve të BQK-së, si dhe zhvillimeve ekonomike dhe financiare në vend.

Komunikimi me mediat ka qenë dhe shpresoj të jetë pjesë e rëndësishme e aktivitetit të BQK-së. Përmes raportimit nga ana juaj, ne kemi arritur që ta mbajmë publikun të mirë informuar rreth zhvillimeve në sistemin financiar dhe ekonominë e vendit. Prandaj, dëshiroj që të shfrytëzoj rastin për të ju shprehur vlerësimin tim të lartë për profesionalizmin e treguar gjatë kësaj periudhe kohore.

Me gjithë vështirësitë me të cilat jemi ballafaquar si institucion, por edhe unë personalisht si Guvernator, jam i lumtur dhe krenar të ju informoj që gjatë pesë viteve të fundit Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur të zbatojë objektivat e saj, duke siguruar një sistem financiar të qëndrueshëm, e sidomos vitet e fundit, arriti të përballojë me sukses krizat e shkaktuara nga pandemia Covid 19 e tani edhe agresioni rus në Ukrainë, por edhe të jetë një nga shtyllat kryesore të mbështetjes për bizneset dhe individët, dhe me këtë edhe të ekonomisë së vendit.

Tani, më lejoni që para jush të paraqes një përmbledhje të zhvillimeve që karakterizuan sistemin financiar të vendit gjatë kësaj periudhe.

Që nga marsi i vitit 2018, me rastin e dekretimit tim si Guvernator, kemi arritur që me sukses të përmbushim rolin tonë kushtetues dhe ligjor përmes vendimmarrjes profesionale të bazuar në standardet dhe parimet e mira të qeverisjes korporative, pavarësisë dhe llogaridhënies.

Sistemi financiar në vend gjatë kësaj periudhe pesë vjeçare, është karakterizuar me zhvillime pozitive dhe rritje të vazhdueshme në të gjithë indikatorët e saj.

Përmes politikës së licencimit, BQK-ja në vazhdimësi ka synuar ofrimin e kushteve sa më të mira për qasjen në financa në Kosovë, duke mundësuar operimin në tregun tonë financiar vetëm të institucioneve, të cilat i kontribuojnë stabilitetit dhe zhvillimit të sistemit financiar, e rrjedhimisht edhe zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të vendit.

Nën udhëheqjen time si Guvernator, BQK-ja ka arritur të siguroj një sistem financiar të qëndrueshëm, stabil, të mirëkapitalizuar dhe likuid. Një qëndrim i ngjashëm lidhur me sistemin financiar në vend mund të evidentohet edhe në raportet e institucioneve financiare ndërkombëtare, si: Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Botërore, Raporti i Komisionit Evropian, Banka Qendrore Evropiane, Departamenti Amerikan i Shtetit dhe shumë institucione tjera.

Gjithashtu, performanca e përgjithshme financiare e BQK-së gjatë kësaj periudhe, ka qenë shumë e kënaqshme, duke realizuar të ardhura gjithëpërfshirëse gjatë gjithë pesëvjeçarit të qeverisjes. Derisa gjatë vitit 2017, BQK-ja kishte rezultat financiar negativ prej 881 mijë euro, në vitin 2018 është realizuar rezultat pozitiv prej 2.2 milionë euro; në vitin 2019 - **2.1 milionë euro**; në vitin 2020,

përkundër pandemisë Covid 19 - **2.16 milionë euro**; në vitin 2021 - **6.1 milionë euro**, ndërsa në vitin 2022 fitimi i paaudituar i BQK-së është në vlerë rreth **8 milionë euro**. Rezultati financiar pozitiv i BQK-së ka mundësuar dhe ka krijuar stabilitet financiar, duke ofruar siguri edhe për qëndrueshmërinë financiare afatgjatë të institucionit të BQK-së.

Sektori bankar në Kosovë gjatë kësaj periudhe ka shënuar rritje të vazhdueshme si në numrin e institucioneve e njëkohësisht edhe në rritje të aktivitetit të këtij sektori. Nga dhjetë banka sa ishin në fund vitit 2018 deri në tetor të vitit 2022, ky numër u rrit në dymbëdhjetë duke ju shtuar edhe dy institucione Financiare me aktivitet bankar.

Sektori bankar përgjatë periudhës 2018 – tetor 2022 ka shënuar rritje të aseteve prej 2.6 miliardë euro ose 61.6 përqind. Vlera totale e aseteve në fund të vitit 2022 ishte 6.76 miliardë euro, nga 4.18 miliardë si ishin në fund të vitit 2018.

Rritja e aseteve të sektorit bankar rezultoi edhe me rritjen e portofolit kreditor që në dhjetor të vitit 2022 arriti vlerën prej 4.35 miliardë eurove, nga 2.75 miliardë sa ishin në vitin 2018. Në kontekstin kohor 2018 – 2022, niveli i kredive aktive u rritën për 1.6 miliardë, ose rritje prej 57.9 përqind gjatë këtyre pesë viteve. Rritja e theksuar e kredive nuk ka ndikuar në rritjen e kredive joperformuese, që në fund të vitit 2022 niveli i kredive joperformuese ishte 2 përqind, i krahasueshëm me sistemet bankare të Bashkimit Evropian. Kreditë vazhdojnë të jenë zëri kryesor bilancor në kuadër të aseteve të bankave me një pjesëmarrje prej 64.3 përqind në dhjetor 2022.

Rritja e kredive është mbështetur kryesisht nga rritja e depozitave ku në dhjetor 2022 niveli i gjithsej depozitave ishte 5.55 miliardë euro, rritje për 2.19 miliardë euro apo 65.1 përqind në horizontin kohor 2022 krahasuar me 2018.

Sektori bankar gjatë gjithë kësaj periudhe, përkundër rritjes së vazhdueshme dyshifrore të kreditimit, ka vazhduar të jetë i mirë kapitalizuar dhe likuid. Raporti i likuiditetit të sektorit bankar vazhdon të jetë i lartë dhe mbi kërkesat rregullative të BQK-së. Nivelin më të lartë të likuiditetit, sektori bankar e kishte gjatë periudhës së pandemisë, në vitin 2020, që ishte 39.8 përqind, ndërsa në dhjetor 2022 ky raport ishte 36.5 përqind, lartë mbi minimumin e kërkuar rregullativ prej 25 përqind. Treguesi i mbulimit me likuiditet (LCR-Liquidity Coverage Ratio) është në nivelin prej 212.1 përqind, që është shumë më lartë se niveli i kërkuar prej 100 përqind (në tremujorin e tretë të vitit 2022 ky tregues në vendet e Eurozonës ishte në nivelin prej 162 përqind).

Kapitali vetanak i bankave ka vazhduar të ketë rritje, përkundër aprovimit të shpërndarjes së dividendës individualisht për bankat gjatë 5 viteve të fundit. Me 31 dhjetor 2022 vlera e kapitalit të sektorit bankar është 699 milionë euro nga 497 milionë euro sa ishte në fund të vitit 2018. Ndërsa treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit vazhdon të jetë mbi minimumin e kërkuar rregullativ gjatë gjithë kësaj periudhe, apo rreth 14.8 përqind në fund të vitit 2022.

Përveç sektorit të bankave, edhe IMF-IFJB-të kanë shënuar performancë stabile, ku në fund të vitit 2022 vlera e aseteve të këtij sektori ishte 387.7 milionë euro, një rritje prej 146.1 milionë euro, apo 60.5 përqind krahasuar me vitin 2018. Sikurse tek bankat, zëri kryesor edhe tek IMF-IFJB-të janë kreditë që në dhjetor 2022 shënuan vlerën prej 351 milion euro, apo rritje për 128.9 milion euro apo 58.0 përqind, krahasuar me vitin 2018. Rritja stabile dhe cilësore e kredive, konfirmohet edhe nga niveli i kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë që në fund të vitit 2022 ishte 1.8 përqind, më ulët krahasuar me vitin 2018 kur ishte 2.2%.

Ndërlidhur me këtë sektor, në vitin 2019 BQK-ja ka tërhequr regjistrimin (licencën) e dy institucioneve, IuteCredit dhe Monego. Të dy këto institucione, kanë bërë ankimime të numërta gjyqësore lidhur me revokimin e licencave, por

që të gjitha rastet gjyqësore deri më tani janë fituar nga BQK-ja. Bazuar në procesin e arbitrazhit të iniciuar nga IuteCredit, gjatë vitit 2021 janë mbajtur një sërë takimesh me kompaninë mbrojtëse dhe janë dhënë deklarata. Në vitin 2022 është mbajtur seanca lidhur me procesin e arbitrazhit, lidhur me padinë e IuteCredit, ku është vendosur tërësisht në favor të Republikës së Kosovës.

Zhvillime tepër pozitive kemi pasur edhe te sektori i sigurimeve. **Asetet e sektorit të sigurimeve**, që përfaqësojnë rreth 3.0 përqind të gjithsej aseteve të sistemit financiar, në fund të vitit 2022 shënuan vlerën prej **267.5 milionë euro**, duke shënuar rritje vjetore prej **12.0 përqind**, ndërsa gjatë periudhës pesë vjeçare kanë shënuar rritje prej 52.2 përqind.

Primet bruto të shkruara nga kompanitë e sigurimit në fund të vitit 2022 shënuan vlerën prej **134 milionë euro**, nga 92.1 milionë euro sa ishin në fund të vitit 2018, apo një rritje gjatë pesë viteve të fundit prej **45.5 përqind**, përderisa dëmet e paguara shënuan vlerën mbi **64.3 milionë euro** apo një rritje prej **49.9 përqind** gjatë kësaj periudhe.

Sikurse edhe jeni në dijeni, sektori i sigurimeve ka qenë një ndër sektorët më problematik, për të cilin, ma rastin e fillimit të mandatit kam vendosur që të filloj me ndërmarrjen e veprimeve me qëllim të përmirësimit të gjendjes së këtij sektori.

Nga 21.8 milion euro sa ishte mungesa e kapitalit në vitin 2018, bazuar në pasqyrat financiare të paadituara, me 31 dhjetor 2022 asnjë kompani e sigurimeve nuk është nën kërkesat për kapital. Ndërsa, mungesa e aseteve të pranueshme në mbulim të provizioneve teknike nga 16.2 milion euro sa ishte me 31 dhjetor 2018, me 31 dhjetor 2022, të gjitha kompanitë janë brenda parametrave të kërkuar rregullativ.

Nga gjithsej 12 sigurues Jo-Jetë sa operonin në Kosovë në vitin 2018, gjashtë prej tyre kishin mungesë të kapitalit dhe asetëve të pranueshme në mbulim të provizioneve teknike.

Si rezultat i masave të ndërmarra nga ana e BQK-së, me qëllim të mbrojtjes së policëmbajtësve dhe parandalimit të rritjes së ndikimit negativ në tregun e sigurimeve dhe në sistemin financiar në përgjithësi, duke u bazuar në detyrat dhe përgjegjësitë që dalin nga Ligji për BQK-në dhe Ligjin për Sigurimet, gjatë kësaj periudhe 2018-2022 BQK-ja ka marrë vendim për revokimin e licencave të dy siguruesve, përkatësisht kompanive të sigurimeve “Insig” dhe “Kosova e Re”. Para marrjes së vendimit, BQK-ja në vazhdimësi ka bërë përpjekje për sanimin e gjendjes financiare tek të dy siguruesit, megjithatë, përkundër gatishmërisë dhe përpjekjeve të BQK-së, Bordi dhe Menaxhmenti i dy Siguruesve nuk kanë arritur t’i përmbushë kërkesat ligjore dhe përmirësimin e gjendjes financiare.

Mbikëqyrja e përafërt dhe kërkesat e vazhdueshme për përmbushjen e kërkesave ligjore, ka rezultuar në injektim të vazhdueshëm të kapitalit nga sektori i sigurimeve në vend. **Gjatë viteve 2019-2022, injektimi shtesë i kapitalit ishte në shumë prej 20.3 milionë euro.**

Gjithashtu, është e rëndësishme të theksohet se gjatë viteve 2018-2022, Bordi Ekzekutiv i BQK-së përmes vendimeve ka bërë shqiptimin dhe marrjen e masave të ndryshme administrative ndaj siguruesve dhe vetëm për sektorin e sigurimeve janë marrë mbi 100 vendime të ndryshme.

Andaj, nëse ka ndonjë gjë për të cilën ndihem krenar, është pikërisht zgjidhja e problemit të sektorit të sigurimeve dhe marrja e masave për përmirësimin dhe pajtueshmërisë së këtij sektori me kërkesat ligjore, duke marrë parasysh se që nga themelimi dhe funksionimi i tij, nuk është marrë askush me këtë sektor dhe zgjidhjen e pajtueshmërisë së tyre me kërkesat ligjore.

Gjatë periudhës pesë vjeçare, Fondet Pensionale në Kosovë kanë shënuar rritje të vazhdueshme. Nga 1.65 miliardë euro sa ishin në fund të vitit 2017, deri në muajin dhjetor të vitit 2022 fondet pensionale kanë arritur në vlerën prej 2.42 miliardë euro. Është e rëndësishme të theksohet se përkundër tërheqjes së 10 përqind të fondeve pensionale gjatë vitit 2020, si rezultat i aprovimit të ligjit për rimëkëmbje ekonomike, në vlerë rreth 200 milionë euro, fondet pensionale kanë vazhduar trendin rritës edhe gjatë viteve vijuese, përkatësisht gjatë vitit 2021 dhe 2022.

Megjithatë, për shkak të lëvizjeve të pafavorshme në tregjet ndërkombëtare, si rezultat i agresionit rus në Ukrainë, gjatë vitit 2022 sektori pensional shënoi rënie të kthimeve në investime, ku rënia e këtyre investimeve gjatë vitit 2022 ishte në vlerë rreth 120 milionë euro. Megjithatë, me përmirësimin e tregjeve financiare, vlerësohet se edhe rënia e vlerës së këtyre investimeve do të rikuperohet. Ndërkohë që kontributet e reja pensionale gjatë vitit 2022 shënuan vlerën prej rreth 242 milionë euro.

BQK-ja ka vazhduar angazhimin e saj edhe në funksion të mbrojtjes së të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, duke i shërbyer kështu në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjes së interesit të qytetarëve. Deri në muajin nëntor të këtij viti, numri i ankesave të shqyrtuara nga ana e BQK-së ka arritur në 810 ankesa. Angazhimi i BQK-së në mbrojtjen e të drejtave të konsumatorëve të shërbimeve financiare, qoftë përmes programeve të edukimit financiar, qoftë përmes masave korrektuese ndaj institucioneve financiare, ka qenë dhe do të mbetet prioritet i BQK-së edhe gjatë viteve të ardhshme.

Për sa i përket zhvillimeve të brendshme, BQK-ja edhe gjatë vitit 2022 ka vazhduar me avancimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të saj profesionale në të gjitha fushat e veprimit të saj.

Përkundër situatës së krijuar dhe kushteve jo shumë të favorshme në tregjet ndërkombëtare, Banka Qendrore e Republikës së Kosovës ka arritur të ruajë qëndrueshmërinë e saj financiare dhe performancën e mirë të institucionit, duke gjeneruar rezultat financiar pozitiv.

BQK-ja mbetet e përkushtuar që të vazhdojë aktivitetin e saj në shërbim të stabilitetit dhe zhvillimit të ekonomisë së vendit, duke krijuar kushtet për zhvillimin e një infrastrukture të qëndrueshme financiare, në linjë me zhvillimet bashkëkohore në këtë fushë, duke përfshirë edhe zhvillimin e segmenteve të reja të sistemit financiar siç është tregu i kapitalit, i cili kërkon një bashkëveprim të gjerë ndërinstitucional.

Për fund, më lejoni që në emrin tim personal dhe në emër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës të shpreh falënderimin më të sinqertë për stafin e vlefshëm të BQK-së dhe t'i falënderoj për punën dhe përkushtimin e treguar në realizimin e detyrave të tyre të punës gjatë kësaj periudhe.

Ju faleminderit dhe mbetshi me shëndet!